




REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
 AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
 AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
 ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. 2-D/DPK Nr. Prot. 01-4557/13
 Dep. 03 Bi Prot. Prot No.
 Nr. i faq. 03 Data 31.12.2013
 Broj stranica 03 Datum 31.12.2013
 Nr. pages 03 Date 31.12.2013
 PRISTINE



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

DATE/A:	24/12/2013
REFERENC-Ë:	AKK-DPK
PËR/ZA/TO:	z. Xhemajl BUZUKU Drejtor i Departamentit të Prokurimit në Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë
CC:	z. Xhavit Dakaj Sekretar i Përgjithshëm
NGA/OD/FROM:	z. Hasan PRETENI Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me Tenderin "Vazhdimi i punimeve në shkollën fillore në Novosell-Pejë"



Të nderuar,

Duke u bazuar në nenin 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.12 të Ligjit për Agjencinë kundër Korrupsionit nr.03/L-159 dhe nenin 19 paragrafi 1, nën paragrafi 1.6 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtimin e Funkcionit Publik, lidhur me tenderin "Vazhdimi i punimeve në shkollën fillore në Novosell-Pejë", me nr. të prokurimit: MASHT 13 082 521, Agjencia kundër Korrupsionit ofron këtë:

OPINION

Në lidhje me monitorimin e Njoftimit për Kontratë për tenderin "Vazhdimi i punimeve në shkollën fillore në Novosell-Pejë" në Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë me numër të Prokurimit: MASHT 13 082 521, I inicuar nga Autoriteti Kontraktues Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë. Gjatë monitorimit të kësaj procedure të prokurimit, Agjencia Kundër Korrupsionit ka evidentuar shkelje të dispozitave të ligjit nr. 04-L/042 për Prokurim Publik

Arsyetim

Zyra e Prokurimit e Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë ka përgatitë “Njoftim Kontratë” me titullin: “Vazhdimi i punimeve në shkollën fillore në Novosell-Pejë” me nr. prokurimi: MASHT-13 082 521, e cila është publikuar në faqen elektronike të KRPP-së me datë 13/11/2013, në Procedurë të Përshpejtuar.

Autoriteti Kontraktues- MASHT përmes ueb faqes së KRPP-së me datë 18.11.2013 anulon këtë aktivitet të prokurimit për arsyet e cekura:

Një shkelje e LPP-së ka ndodhur apo do të ndodh në procedurën e prokurimit, e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amendamenti ligjor të kushteve të prokurimit, dhe

Ndërprerja e aktivitetit të prokurimit është i nevojshëm për shkak të ngjarjeve dhe/apo arsyeve objektive dhe të demonstrueshme të cilat janë jashtë kontrollit të autoritetit kontraktues dhe të cilat kanë qenë të paparashikueshme në kohën e inicimit të aktivitetit të prokurimit.

Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë bëri ri shpalljen e këtij aktiviteti të Prokurimit më datë 18.11.2013, “Njoftim për Kontratë- Ri tenderim-Punë”.

Ku tek rubrika III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar tek pika 4 e Njoftimit për Kontratë dhe Dosjes së Tenderit kërkohet:

Kërkohen së paku 50 punëtorë për tm. të evidentuar në ATK, duke përfshirë edhe stafin menaxherial të projektit edhe tremujorin e vitit 2013.

Po ashtu A.K tek pika 07 e rubrikës “Kërkesat minimale mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale kërkohet:

Në rast të Konzorciumit, Lideri i grupit duhet të ketë të përmbushur së paku 70% të kërkesave për secilën, kontratat dhe raportet mbi pranimin e punëve nga Komisioni për pranim Teknik për kontratat e prezantuara



Agjencia kundër Korrupsionit- Departamenti për Parandalimin e Korrupsionit në Prokurim publik konsideron se veprimet e Autoritetit Kontraktues të cekura më lartë bien ndesh me Nenin 69 Aftësitë Teknike dhe/ose Profesionale dhe Nenin 71 Grupet e Operatorëve Ekonomik dhe Operatorët e Huaj Ekonomik të Ligjit për Prokurimit Publik Nr. 04/L-042.

Agjencia kundër Korrupsionit- Departamenti për Parandalimin e Korrupsionit në Prokurim publik ka kontaktuar përmes telefonit Departamentin e Prokurimit pranë MASHT në lidhje me pikat e evidentuara .

AK-MASHT u pajtua që para hapjes së tenderit të bëjë përmirësimin e këtyre dy pikave duke bërë përmirësimin e Dosjes së Tenderit dhe duke njoftuar të gjithë OE për ndryshimet e bëra në dosjen e tenderit.

Në mbështetje të nenit 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Me respekt!